



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:155006

Datë: 03.03.2021

Numri i dokumentit: 01560701

P.nr.898/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit SH.A. nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzave së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1814/2020, të datës 09.11.2020 dhe PP.II.nr.78/2021, të datës 12.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 16.02.2021, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 03.03.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri SH.A., nga babai H. dhe nëna N., e lindur A., i lindur me datë ne fshatin I., Komuna e Preshevës ndërsa me vendbanim në Gjilan, rruga: “.....”, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 6 fëmijëve, pensionist, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

Nga data ... e deri me datë ... në rrugën: “.....” në Gjilan, në shtëpinë e tij, i pandehuri, si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka vjedh shërbime komunale të energjisë elektrike pasi në vazhdimësi ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike dhe i është vendosur njehsori elektrik me komandë nga distanca pas vërtetimit të gjendjes faktike në teren, nga ekipi e kontrollit të KEDS është vërtetuar se i njëjti në mënyrë të paautorizuar është lidhur direkt në rrjet nga ku është furnizuar me energji elektrike dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme dhe të paautorizuara, ka shpenzuar energji elektrike të paautorizuar, duke dëmtuar KEDS Distrikti në Gjilan në vlerë të papërcaktuar.

II.

Sepse nga data në kohë të a vërtetuar, në Gjilan i pandehuri në vazhdimësi në mënyrë të paautorizuar, ka shfrytëzuar energji elektrike, në atë mënyrë që derisa i pandehurit për shkak të mos pagesës së borxhit është ç’kyçur nga rrejtja elektrik, e me rastin e kontrollimit punëtoret e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se i pandehuri SH.A. si shfrytëzues i energjisë elektrike me qëllim që vetës ti sjell pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik me çka ka pamundësuar regjistrimin shpenzuar të energjisë elektrike, duke dëmtuar KEDS distrikti në Gjilan në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës,

Andaj, në bazë të neneve 4,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe nenit 248 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin SH.A.:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Gjykata duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 4 i KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta lirojë nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

ARSYETIM

1. Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 09.11.2020 dhe 12.01.2021, kundër të pandehurit SH.A. ka ngritur aktakuzat me numra PP.II.nr.1814/2020 dhe PP.II.nr.78/2021, që të dyja për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me datë 16.02.2021, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri me ç'rast pas leximit të aktakuzave lëndore i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se i kishte kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale¹ e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: procesverbalet mbi konstatimin e gjendjes faktike në terren me numër 2494424 i datës 14.08.2019,

¹ Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare si dhe duke pasur parasysh se ndaj të akuzuarit ishin duke u zhvilluar dy procedura penale në të njëjtën kohë, për vepra penale të njëjta me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale në kuptim të nenit 35 të KPP-ës kishte marrë aktvendim procedural te veçantë me të cilin kishte bashkuar procedurat penale ndaj të akuzuarit edhe atë për lëndët P.nr.898/20 dhe P.nr.22/21, po ashtu në seancën e shqyrtimit fillestar para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale duke i konsideruar veprat penale të lartcekura në një vepër penale në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës meqenëse plotësoheshin kushtet ligjore për një gjë të tillë.

fatura me numër DGLHP198140 e datës 25.09.2019, fatura me numër DGLHP198069 e datës 15.08.2019, fatura me numër DGLHP 209293 e datës 14.05.2020, fatura me numër DGLHP209429 e datës 17.06.2020, procesverbalet me numra 2400289 dhe 2407816 të datave 13.05.2020 dhe 16.06.2020, fotografitë e njehsorit elektrik për gjendjen në terren, kalkulimi RH me numër 301816 e datës 14.05.2020. si dhe shkresat e lëndës, gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri SH.A. ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit dhe atë se i njëjti është person i shtyer në moshë përkatësisht i njëjti është pensionist dhe mbajtës i familjes.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, ka kërkuar falje për këto veprime duke shtuar se këto veprime i ka bërë për shkak të gjendjes së varfër ekonomike ngase i njëjti është mbajtës i familjes nga të cilët nuk punon askush dhe e gjithë mirëqenia e tyre varet nga pensioni të cilin e merr i pandehuri duke shtuar këtu edhe faktin se i njëjti njëkohësisht edhe duhet të përkujdeset për bashkëshorten e tij të sëmurë, po ashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori moshën e tij si dhe faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa rrethana rënduese si në kuptim të nenin 70 të KPRK-ës gjykata nuk gjeti ndonjë. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim (neni 47 i KPP-ës) vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh se në dispozitivat e aktakuzave është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm RH të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 4 i KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta lirojë nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale ngase duke u bazuar në gjendjen e tij ekonomike përkatësisht faktin se i njëjti është pensionit fakt ky i cili vërtetohet edhe nga kartela e pensionit e lëshuar nga Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjykata erdhi në përfundimin se pagimi i shpenzimeve procedurale do të rrezikonte gjendjen e tij edhe ashtu të rënduar materiale e po ashtu edhe të anëtarëve të tjerë të familjes për të cilët i njëjti detyrohet që ti mbështes materialisht.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.898/2020, me datë 03.03.2021

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.